

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Hipoklorit Natriumi per nevojat e shoqerise”

Numri i referencës së procedurës : REF44265-04-09-2025

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Hipoklorit-Natriumi

VLERA E FONDIT LIMIT: 6,624,000 (Gjashte milion e gjashteqind e njezete e kater mije) leke pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Shoqeria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sarandë Sh.A Sarandë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022-2023-2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit që prokurohet.

2.2.2 Kopje te certifikuara te bilanceve per 3 vitet e fundit (2022-2023-2024) te konfirmuara nga autoritete perkatese. Kjo kerkese konsiderohet e permbushur nese ne dy bilance te njepasnjeshme nuk ka raport negativ ndermjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2, c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros se percaktuar dhe te kerkuar nga autoriteti kontraktor kerkohet për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike te operatorit ekonomik si dhe per të vendosur kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të jetë pajisur me Liçence nga QKL (Qendra Kombetare e Licensimit), per objektin e aktivitetit, sipas objektit te prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1, a) dhe c), të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërket që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve per proceduren e hapur te thjeshtuar eshte percaktuar se vlera totale e kërkuar duhet të jetë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit që prokurohet., dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

2.3.3 Çertifikatat që duhet të paraqesin Operatorët Ekonomikë:

- Certifikatë ISO 9001 - 2015 “Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, objekti i se cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- Certifikatë OHSAS 18001-ose 45001-2018 “Për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë”, ose Certifikatën e përditësuar Certifikatë ISO 45001-2023, objekti i se cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

Shënim: Të gjitha standartet e kërkuara me sipër nga Autoriteti Kontraktor, do të pranohen edhe ekuivalentet të tyre, standarteve shqiptare me shenimin ”SSH” të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto standarte janë unifikuar nga kjo Drejtori.

Nëse certifikatat janë në gjuhë të huaj, ato të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Këto certifikata të jenë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga organizmat ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat e mësipërme sipas natyrës së punimeve që do të marrë përsipër të realizojë, referuar kontrates së bashkëpunimit të nënshkruar.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik1” në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: aftësinë teknike dhe profesionale;...Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 përcaktohet: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.” Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë, standartet për shëndetin dhe sigurinë në punë. Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret si më lart duke qenë në përpjesëtim dhe të lidhura me objektin e kontratës, por edhe sepse ato i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin e besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. - Certifikatë ISO 9001 - 2015 “Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi si dhe mundëson implikimin në menaxhim, identifikimin e riskut dhe mundësive, sigurimin e konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, etj. Kjo kërkesë shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, për të verifikuar dhe garantuar që Operatori ekonomik ofertues është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë. - Certifikatë OHSAS18001-20215 ose ISO 45001-2018 “Për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë”, ose certifikatën e përditësuar Certifikatë ISO 45001-2023, mundëson që çdo shoqëri të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, dhe përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve, hetimin e incidenteve etj. Kjo kërkesë është vendosur duke iu referuar natyrës dhe specifikës që mbart objekti i prokurimit që lidhet me procese pune ndërtimi. Rreziqet që lidhen me punën në kantier janë të shumta e për këtë arsye, Autoriteti kontraktor duhet të sigurohet se Operatorët ofertues zotërojnë kapacitetet për menaxhimin, kontrollin dhe parandalimin e risqeve për

sigurinë e jetës dhe shëndetit gjatë procesit të punës. Pajisja me këtë lloj çertifikate dëshmon se subjekti plotëson kërkesat e paraqitura nga ky standard për identifikimin, kontrollin dhe zvogëlimin e risqeve, të lidhura me shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë raport analizë fiziko-kimike dhe analizë toksikologjike të bera prane autoriteteve shqiptare, sic është Instituti i Shëndetit Publik (ISHP), si strukturë e specializuar për vlerësimin e produktit /eve biocid/e kompetente për vlerësimin higjienik dhe leshimin e lejes së përdorimit të lëndës dezinfekante. Kjo fletë analize, duhet të jetë brenda një afati tre mujor, nga data e zhvillimit të procedurës.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 6 c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar .ne të cilin thuhet se;

“Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”*

2.3.5 Operatori Ekonomik ose furnitori i tij duhet të garantojë sasinë e produkteve të prokuruar në këtë procedurë, nepermjet ; (a) nëse është prodhues me një deklaratë të tij (b) nëse është tregëtues duhet të disponojë një kontratë me prodhuesin(t) për sasinë e prokuruar të barabartë ose më të lartë nga ajo e kërkuar në këtë procedurë

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në të cilin thuhet se;

“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

2.3.6 Operatori Ekonomik, për automjetin transportues, duhet të paraqesë Certifikatë „ADR,PER TRANSPORTIN E MALLRAVE TË RREZIKSHME” të lëshuara nga DPSHTRR , kur automjeti është në pronesi të tij, dhe kur automjeti është marrë me qira, përveç certifikatës së mësipërme, duhet të paraqesë, Kontratë Qiraje (ose huapërdorje) me akt-noterial, të vlefshme deri në përfundim të kontratës. Në rast se operatori ekonomik është importues, atëherë duhet të paraqesë në sistemin elektronik , Lejen e Importit të lëshuar nga Komisioni i Licensave prane Ministrisë së Shëndetësisë për llojet e sasiive e kimikateve të përcaktuara në DST.

Në rast se operatori ekonomik është prodhues vendas atëherë duhet të paraqesë në sistemin elektronik ,leje mjedisore të tipit A të lëshuar nga QKL, për të gjitha kimikatet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në të cilin thuhet se;

“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

dhe ne

Ligjin 118/2012, neni 12, "Per Transportin e Mallrave te Rrezikshme" dhe ne Udhezimin nr Nr.15 datë 24.7.2007, I ndryshuar, neni 6, "Per Kriteret dhe Procedurat e Leshimit te Licensave, Autorizimeve dhe Certifikatave, per Ushtrimin e Veprimtarise ne Transportin Rrugor"

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim

SPECIFIKIMET TEKNIKE TE HIPOKLORIMIT TE NATRIUMIT

1.Specifikimet teknike te kimikateve per trajtimin e ujit

Procesi teknologjik i trajtimit te ujit te pijshem realizohet me perdorimin e Hipokloritit te Natriumit 13-15% i cili sherben si oksidues dhe densifektues.

Hipokloriti i Natriumit(NaOCl) qe do te perdoret per ujin e pijshem si komponim kimik,duhet te jete me parametra fiziko-kimike ne perputhje me vlerat parametrike te shprehura ne rregulloren:

"CILESIA E UJIT TE PISHEM "MIRATUAR ME V.K.M NR.379 DATE 25.05.2016

A. Hipoklorit Natriumi (NaClO)

1.Lende e paster kimikisht

2.Lende me perqendrim klor aktiv ,13-15%

3.Lenda duhet te jete e shoqeruar me dokumenta si me poshte:

a.Certifikate cilesie e marre ne vendin ku eshte prodhuar kjo lende (e perkthyer ne shqip dhe e noterizuar nqs vjen nga jashte)

b.Raport analiza fiziko-kimike ,toksikologjike ,te bera prane autoriteteve shqiptare,competente per kete ekzaminim dhe leshim te lejes se perdorimit te lendes denzifektante per UJIN E PISHEM, ne nje institucion si Instituti I Shendetit Publik (ISHP) si strukture e specializuar per vleresimin e produktit.

2.Specifikat e automjetit qe do te shërbejë për furnizimin e kimikateve

Furnizimi me kimikate do të kryhet me automjet tip bot ose kamion te certifikuar për transportin e lëndëve të rrezikshme sipas standartit të BE. Çisternat e botit apo depozitat e kamionit për transportin e kimikateve duhet të jenë të përshtatëshme për të mbajtur prodhim të destinuar për trajtimin e ujit të pijshëm. Ato nuk duhet të kenë transportuar më parë substanca të dëmshme ose të konsideruara si të tilla për ndotjen e ngarkesës së kimikatit.

3.Specifikat e automjetit qe do të shërbejë për furnizimin e kimikateve

1.Furnizimi me kimikate do të kryhet me automjet tip bot ose kamion te certifikuar për transportin e lëndëve të rrezikshme sipas standartit të BE. Çisternat e botit apo depozitat e kamionit për transportin e kimikateve duhet të jenë të përshtatëshme për të mbajtur prodhim të destinuar për trajtimin e ujit të pijshëm. Ato nuk

duhet të kenë transportuar më parë substanca të dëmshme ose të konsideruara si të tilla për ndotjen e ngarkesës së kimikatis.

4.Grafiku i furnizimit, dhe oraret e dorëzimit të ngarkesave

Furnizimi i Hipokloritit të Natriumit do të bëhet sipas kërkesës së Shoqërisë Rajonale Ujësjellës -Kanalizime Sh.a Sarandë, por përgjithësisht me sasi proporcionale rreth 10.000kg në mënyrë periodike, përafërsisht çdo dy-tre muaj. Furnizimi do të njoftohet për këtë, 7(shtatë) ditë përpara në formë shkresore ose elektronike. Në ndomje rast, furnizimi duhet të jetë i përgatitur që të plotësojë edhe ndomje kërkesë me urgjente, të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sarandë sh.a.

5. Kontrolli i cilësisë dhe sasisë së ngarkesave të kimikateve

Në ditën e dorëzimit të ngarkesës, do të merren nga ngarkesa me përzgjedhje të pakten 3(tre) kampjone, të cilat do të vendosen në enë të përshtatshme, të vëlosura dhe të firmosura nga marrësi dhe transportuesi, dhe nga të cilat 1(një)do të dorëzohet nëpërmjet autotransportuesit të firmës furnizuese dhe 2(dy)laboratorit fiziko -kimik të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sarandë sh.a, për analizë dhe verifikim. Njëra nga 2(dy)kampjonet do të ruhet për kontrollin e analizës përfundimtare në rast kundërshtimi të furnizuesit. Në një situatë të tillë të dy palet do të ndjekin bashkërisht kontrollin e analizave, mbi kampjonin e vëlosur si dhe atë të firmës furnizuese në qoftë se mbi atë nuk është vënë dorë, e të nënshkruhen me marrëveshje të arsyeshme. Firma furnizuese që nga momenti në mënyrë të verbalizuar është lajmëruar për faktin e mospërfundimit të cilësisë së ngarkesës me specifikimet teknike në përputhje me të cilat ka fituar garën, ka 10(dhjetë)ditë kohë për të prezantuar kundërshtime e veta, në të kundërtë e humb këtë të drejtë.

Për kontrollin e sasisë, komisioni i marrjes në dorëzim do të hartojë procesverbalet përkatëse.

6. Dokumentacioni shoqëruar i çdo ngarkese të kimikateve të trajtimit të ujit

Firma furnizuese përpara se të realizojë shkarkimin e kimikateve për çdo ngarkesë të dorëzuar duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm

- 1- Çertifikatën e origjinës ku jepet origjina e produktit, në origjinal.
- 2- Fletë-analizë e prodhuesit për sasinë e kimikatis të ofruar, në origjinal.
- 3- Raport Analizën të lëshuar nga Inspektorati Sanitar Shtetëror, në origjinal.
- 4- Për kimikatin e furnizuar duhet të paraqitet skeda e sigurisë në origjinal.
- 5- Duhet të paraqitet që me ngarkesën e parë të produktit të furnizuar Leja e Importit të lëshuar nga Komisioni i Liçensave pranë Ministrisë së Shëndetësisë për Hipokloritin e Natriumit (e noterizuar)

4-Per shpenzimet

Te gjitha shpenzimet duke perfshire ato, te transportit dhe shkarkimit te kimikateve ne magazinën e Shoqerise Rajonale Ujesjelles Kanalizime Sarande sh.a si dhe te analizave qe do te kryhen perkatesisht per cdo ngarkese dhe parti malli nga nje institucion shteteror, si Instituti i Shendetit Publik ose nje institucion i kredituar ne vend do te jete ne ngarkim te firmes fituese.

Më pas u vendos për këto çështje:

Vlefshmëria e ofertës 150 ditë.

Kriteret e vlerësimit: Është çmimi më i ulët i ofruar.

Afatet e ekzekutimit janë : 1 vit nga lidhja e kontrates

Komisioni unanimitisht bëri miratimin e tyre dhe u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave, në Sistemin Elektronik.

Per Njesine e Prokurimit

Renato Beduli **Jurist**

Algert Bajrami **Inxhinier**

Evelina Takaj **Kimiste**